

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Ilmi Dalipi dhe Sahit Boroci, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. A., nga Gj., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati V. I., nga Gj. dhe ndaj të akuzuarit B. N., nga fshati L. i E., Komuna e Gj., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati N. N., nga Gj., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,¹ sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP/I.nr.219/2013, të datës 01.10.2013, të cilën e përfaqësonte prokurori Shaban Spahiu, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore dhe publike, më datën 14.04.2014, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit :

1. A. A., nga babai B. dhe nëna A., e lindur S., i lindur më ..., në A., tani me vendbanim në Gj., rr.”...”, p.n, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për ndonjë vepër tjetër penale dhe

2. B. N., nga babai S. dhe nëna F., e lindur I., i lindur më ..., në Gj., tani me vendbanim në fshatin L. i E., Komuna e Gj., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i dënuar edhe më parë për vepër tjetër penale,

JANË FAJTOR

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Me datën2013, rreth orës ... minuta në Gjilan, në rrugën afër hyrjes së shkollës fillore "...", në Gjilan, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror kanë tentuar të kryejnë vjedhje të rëndë ndaj të dëmtuarave N. V.dhe E. B., nga Gj., në atë mënyrë që përderisa të dëmtuarat po kalonin rrugës të akuzuarit i shohin ato dhe vendosin të kryejnë grabitjen ndaj tyre në atë mënyrë që u shkojnë nga mbrapa dhe i akuzuari B., ia kap me duar çantën që e dëmtuara N. e kishte të varur në qafë dhe duke e mbajtur me dorë duke tentuar me ia grabitë të njëjtën ndërkaq i akuzuari A., në të njëjtën kohë tenton t'ia grabitë zinxhirin e argjendit të dëmtuarës E., në atë mënyrë që e kap për xhemperi afër qafës por që në ato çaste e dëmtuara N. bërtet me zë të lartë, kërkon ndihmë nga kalimtarët e rastit, si dhe për ta larguar të akuzuarin B. edhe pse nuk e ka njohur, të njëjtit i drejtohet me fjalët "largohu se po të njohë" dhe pas këtyre fjalëve ky i akuzuar vë në kokë kapelën e duksit që kishte të veshur dhe lëshon çantën e saj, ku me këtë rast vrapon duke ikur nëpër oborr të shkollës, e po ashtu edhe i akuzuari A., lëshon të dëmtuarën E. dhe vrapon pas të akuzuarit të parë, po ashtu nëpër oborr të shkollës, ashtu që nuk arrijnë t'i grabisin sendet e përmendura,

- me këtë kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë e mbetur në tentativë, nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 2 lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK.

Andaj, trupi gjykues në bazë të dispozitave të lartcekura ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,² të akuzuarve ju shqipton :

DËNIM ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarve A. A. dhe B. N., secilit veç e veç ju shqiptohet dënimi me burgim prej nga 1 (një) vjet dhe dënimi me gjobë në shumë prej nga 200 € (dyqind Euro), të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse të akuzuarit refuzojnë që të paguajnë dënimet me gjobë ose nuk janë në gjendje ti paguajnë ato, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të akuzuarve mund

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse të akuzuarit nuk pajtohen me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga 1 (një) ditë burgim.

Detyrohen të akuzuarit që secili veç e veç ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 30 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Historiku i procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më datën 02.10.2013, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarve A. A., nga Gj. dhe B. N., nga fshati L. i E., Komuna e Gj., për shkak të veprës penale grabitje e mbetur në tentativë, nga neni 329 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 14.04.2014, prokurori Shaban Spahiu, gjatë fjalës përfundimtare, e ka ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale, me ç'rast të akuzuarit A. A. dhe B. N., i ka akuzuar për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 lidhur me nenin 28 të KPRK, duke i propozuar trupit gjykues që të akuzuarit t'i shpall fajtor për kryerjen e kësaj veprë penale dhe t'i dënojë sipas ligjit.

I akuzuari A. A. dhe mbrojtësi i tij, avokati V. I., gjatë fjalës përfundimtare, i kanë propozuar trupit gjykues që ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i butë, nëse gjykata gjen prova se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. N., avokati N. N., gjatë fjalës përfundimtare i ka propozuar trupit gjykues që nëse gjen rrethana inkriminuese, atëherë i akuzuari B. N., të shpallet fajtor për shkak të veprës penale vjedhje, nga neni 325 paragrafi 1 i KPRK.

I akuzuari B. N., gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me fjalën e mbrojtësit të tij, duke shtuar se jam penduar për këtë vepër që ka kryer dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla.

2. Konstatimet e trupit gjykues

Pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, trupi gjykues e vërtetoi këtë gjendje faktike :

- se është vërtetuar se të akuzuarit A. A. dhe B. N., me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë tentuar që të kryejnë veprën penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 2 lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK.

Trupi gjykues, duke u bazuar edhe në nenin 360 paragrafi 2 të KPPK, ka ardhur në përfundim se të akuzuarit A. A. dhe B. N., duhet të shpallen fajtor për shkak të veprës penale të lartcekur, edhe pse prokurori shtetit gjatë fjalës përfundimtare nuk e ka përmendur nenin 31 të KPRK, ngase vepra penale është tentuar që të kryhet në bashkëpunim. Duke i marrë për bazë të këto fakte, trupi gjykues ka konstatuar se tek kualifikimi ligjor i veprës penale duhet të shtohet edhe neni 31 i KPRK.

3. Provat e administruara

Gjendjen faktike të cekur më lartë, trupi gjykues e ka vërtetuar duke u bazuar në këto prova :

- Deklaratat e të dëmtuarave N. V.dhe E. B., si dhe
- Pjesërisht nga deklaratat e të akuzuarve A. A. dhe B. N..

3.1. Deklaratat e të dëmtuarave

E dëmtuara N. V., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se lidhur me këtë çështje penale ka dhënë një deklaratë edhe te prokurori i shtetit dhe i përmbahet në tërësi kësaj deklaratë. Ka deklaruar se të dëmtuarën E. B. e ka kumatë dhe para se t'ju ndodhte rasti, nuk i kanë vërejtur të akuzuarit ngase të njëjtit kanë ardhur nga mbrapa. Rasti ka ndodhur afër shkollës fillore “...” në Gj. dhe i akuzuari i cili është më i gjatë (duke iu referuar të akuzuarit B. N.) është marrë me mua, ndërsa i akuzuari që është më i shkurtër (duke ju referuar të akuzuarit A. A.) është marrë me kunatën time E. B.. I akuzuari B. ka tentuar që ta kap çantën time të cilën e kisha të varur në krahë dhe qafë, ku njëherë ka arritur të ma kap çantën. Unë i kam thënë të akuzuarit lëshomë se po të njoh kush je edhe pse nuk e kam njohur, ndërsa i njëjti pas kësaj e ka vendosur kapelën e duksit në kokë dhe kanë ikur njeri pas tjetrit pas shkollës fillore “...”. Gjatë atij momenti kur i akuzuari B. tentonte që të ma grabiste çantën, unë kërkoja ndihmë, mirëpo askush nuk ma ofronte një ndihmë të tillë, kurse në anën tjetër duke marrë parasysh

faktin se kunata ime ishte e sëmure ngase e njëjta nuk e ka një veshkë unë u brengosesha për shëndetin e saj sepse e njëjta ishte e pambrojtur.

I akuzuari që është më i shkurtër (duke iu referuar të akuzuarit A. A.) tentonte që kunatës sime t'ia merrte zinxhirin e qafës, në të njëjtën kohë kur mua i akuzuari B. tentonte të ma merrte çantën. Meqë çantën time unë e kam kapur me dy duar, atëherë jam bindur se i akuzuari nuk ka mundësi të ma merr çantën time, kështu që kam kërkuar ndihmë prej njerëzve dhe jam përkujdesur edhe për kunatën time. Çanta ka qenë një çantë e vogël ngjyrë e zezë dhe kjo çantë ka qenë e vendosur në njërën pjesë të krahut e lidhur me rrip përmes qafës me pjesën tjetër të trupit. Të akuzuarit nuk kanë patur ndonjë armë me veti dhe nuk na kanë kanosur dhe as që na kanë lënduar. Ky rast ka zgjatur diku rreth 5 minuta, sepse të akuzuarit fillimisht kanë ardhur nga mbrapa, mandej njeri ka shkuar tek kunata, ndërsa tjetri tek unë. I akuzuari tentonte të ma merrte çantën mirëpo unë e kisha kapur çantën me dy duar. Të akuzuarit bashkërisht në të njëjtën kohë kanë tentuar që të na grabisin. Edhe i akuzuari që është më i shkurtër (A. A.) ka tentuar t'ia marrë zinxhirin nga qafa, mirëpo nuk ka mundur ngase edhe ajo bërtitke me zë dhe kërkonim ndihmë prej njerëzve. Momenti kur të akuzuarit tentonin për të na grabitur, unë me kunatën time kam qenë shumë afër, ngase edhe ashtu kemi qenë së bashku duke ecur. Në çantë unë kisha 600 Euro, kuletën e kunatës sime dhe tre telefona, ndërsa kunata ime nuk kishte çantë atë ditë dhe për këtë në çantën time e ka vendosur kuletën e saj. Pas kësaj ne kemi shkuar në shtëpi dhe kur djali më ka vërejtur se nuk jam mirë, atëherë ai e ka thirr policinë.

Trupi gjykues, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 20.03.2014, duke u bazuar në nenin 338 paragrafi 1 nënparagrafi 3 të KPP, ka vendosur që të lexohet deklarata e të dëmtuares E. B., e dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, ngase palët janë pajtuar për një gjë të tillë.

E dëmtuara E. B., gjatë dhënies së deklaratës në Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më datën 01.10.2013, ka deklaruar se lidhur me këtë çështje penale e ka dhënë edhe një deklaratë në polici dhe e mbështet të njëjtën. E njëjta ka deklaruar se me datën kritike përderisa unë isha me kunatën time N.n, ku kemi qenë duke u kthyer në shtëpi në rrugë afër së Shkollës “...” bile në afërsi të hyrjes së oborrit të shkollës, për një moment dy persona dhe atë njëri më i gjatë me duks të zi, ndërsa tjetri më i shkurt (nuk më kujtohet se çka ka pas të veshur), për një herë ai personi më i gjati ka tentuar që kunatës sime t'ia kap çantën që e kishte të varur në qafë, kurse ai personi më i shkurtër më ka kap për xhemperi duke tentuar të ma kap zinxhirin e argjendit. Unë kam bërtitur pse more “prosnjak çka jemi duke ju ba”. Gjithashtu, edhe kunata ime N. ka bërtite më zë të lartë dhe në ato çaste personi më i gjatë e ka vu kapelën e duksit në kokë dhe ka filluar të ik në oborr të shkollës e pas tij edhe personi më i shkurtër që donte të ma merrte zinxhirin më ka lëshuar dhe ka vrapuar pas tij. Pas kësaj, ne kemi shkuar në shtëpi dhe djali i kunatës e ka njoftuar policinë.

3.2. Deklarimet e të akuzuarve

I akuzuari A. A., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor e ka mohuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale, mirëpo ka shtuar se është e vërtetë se ditën kritike përkatësisht me datën ... 2013, rreth orës ... kam qenë së bashku me të akuzuarin B. N., duke shkuar nga qendra e qytetit në drejtim të lagjes “A.ia”. Natën kritike, i akuzuari ka deklaruar se është takuar me ato gratë (të dëmtuarat), me ç’rast i akuzuari B. N. ka tentuar me ia marrë çantën ose zinxhirin, ndërsa unë nuk kam ndërmarrë asnjë veprim. Meqë shoku i im nuk arriti që t’ia marrë çantën, ne kemi filluar që të ikim. Nuk është e vërtetë se unë të kem tentuar të dëmtuarës E. t’ia marr zinxhirin nga qafa. Natën kritike me të akuzuarin B. jam takuar diku në mes dite dhe me të kemi qëndruar deri në mbrëmje. Ne paraprakisht kur i kemi parë këto dy gratë kemi biseduar me njeri tjetrin për t’ia marrë çantën njëres nga këto. Unë nuk kam vërejtur që ndonjëra prej tyre të ketë pasur zinxhirë në qafë.

I akuzuari A. A. është ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, me datën 01.10.2013, ku i njëjti kishte thënë se “ne kemi vërejtur paraprakisht dy gra duke kaluar rrugës së përmendur, andaj pasi që iu kemi parë zinxhirë të arit në qafë kemi vendos me iu grabitur zinxhirët e arit, ndërsa sot deklaron se paraprakisht se i njëjti nuk ka vërejtur te ndonjëra prej tyre zinxhirë në qafë”. Edhe pas këtij ballafaqimi, i akuzuari A. A. deklaron se e vërteta është ajo çka po e them sot pra “unë paraprakisht nuk iu kam parë zinxhirin në qafë atyre grave” dhe unë e kam parë që vetëm kur i akuzuari B. N. ka tentuar që t’ia marrë zinxhirin njëres prej këtyre grave atëherë në atë moment unë e kam parë zinxhirin. Këto gra, ne më parë nuk i kemi njohur dhe arsyeja pse ne kemi tentuar që ti grabisim është se neve na u nevojiteshin para për drogë dhe alkool, kështu që tentonim të përfitonim në këtë mënyrë. I akuzuari B. N. tentoi për t’ia marrë zinxhirin ku i njëjti ia kapi zinxhirin dhe ia shqyti bluzën, ajo grua filloi që ti thotë “o prosnjak po të njoh kush je dhe lëshomë”, mandej pas kësaj ne jemi larguar nga vendi i ngjarjes. Këto gra kanë qenë duke ecur para neve natën kritike dhe të njëjtat i kemi përcjellë nga një autolarje e cila gjendet përballë hyrjes për në marketet “...” dhe “...” deri në hyrjen e shkollës fillore “...”. Gjatë kësaj kohe derisa ne i përcillnim këto gra dhe planifikuam që t’ia marrim çantën, ndërsa kur u ofruam afër tyre i akuzuari B. tha që t’ia marr zinxhirin. Kur B.i tentoi që t’ia marrë zinxhirin njëres prej këtyre grave, ne menjëherë kemi ikur dhe fillimisht unë kam menduar se B.i ia ka marrë zinxhirin, mirëpo kur kemi arritur te varrezat, i njëjti më tha se nuk arrita që t’ia marrë zinxhirin. Kur ajo gruaja i tha B.it ndalu se po të njoh unë mendova se me të vërtetë po e njeh. Siç e thashë edhe më parë, ne bëmë plan paraprakisht që t’ia marrim çantën bashkërisht, mirëpo i akuzuari B. tha që unë po ia marr zinxhirin dhe këtë e bëri vet, kështu që ne nuk patëm kohë për t’ia marrë çantën bashkërisht.

I akuzuari B. N., pas leximit të aktakuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor, e ka pranuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale, mirëpo trupi gjykues ka

konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP dhe ka vazhduar me procedimin e provave edhe për këtë të akuzuar. I njëjti ka deklaruar se natën kritike unë kam qenë nën ndikim të drogës dhe alkoolit dhe kam mbetur pa para, kështu që kam tentuar që të siguroj të holla duke ia marrë zinxhirin njëres prej këtyre grave dhe ky rast ka ndodhur pa ndonjë plan, përkatësisht ka ndodhur papritmas. Ne kemi qenë mbrapa këtyre grave duke ecur dhe i akuzuari A. A. nuk ka qenë i vetëdijshëm se për atë çka unë po dua me të dhe ne nuk kemi bërë plan për këtë. Unë vetëm njëres prej këtyre grave kam tentuar që t'ia marr zinxhirin, mirëpo nuk kam arritur. Unë nuk kam mundur që ta preki me dorë zinxhirin të dëmtuarës.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari B. N., është ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më datën ... 2013, ku i njëjti kishte thënë “se natën kritike kemi vërejtur dy femra duke ecur rrugës dhe kemi vërejt se kanë zinxhir në qafë, me ç'rast kemi vendosur që t'ia grabisim zinxhirët në qafë”, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ne nuk kemi patur ndonjë plan paraprak për ta kryer këtë veprë penale. I akuzuari B. N., ka deklaruar se e vërteta është ajo çka po e them sot. Më pastaj i njëjti ka deklaruar se nuk është e vërtetë se unë kam tentuar t'ia marr me forcë çantën njëres prej këtyre grave. Derisa unë kam tentuar që t'ia grabis zinxhirin ajo gruaja ka bërë titur, ndërsa më pas kam ikur dhe unë nuk kam pasur ndonjë kapelë në kokë natën kritike. A.i gjatë momentit kritik vetëm ka qëndruar dhe nuk ka vepruar dhe nuk ka bërë asgjë. I njëjti nuk e ka ditur që unë po tentoj t'ia marr zinxhirin. Gruaja tjetër që ishte së bashku me këtë gruan që tentova me ia marrë zinxhirin, nuk e kam vërejt se çka ka bërë në ato momente.

Kryetari i trupit gjykues, ka bërë ballafaqimin e deklaratës së të akuzuarit B. N. me deklaratën e të akuzuarit A. A., sidomos te fakti që ka të bëjë me atë se a e ka ditur përkatësisht a kanë planifikuar paraprakisht i akuzuari A. me të akuzuarin B. N. që t'ia grabisin zinxhirin njëres prej këtyre grave.

I akuzuari B. N. pas ballafaqimit ka deklaruar se nuk më kujtohet nëse i akuzuari A. A. e ka ditur që unë po dua me ia marrë zinxhirin njëres prej këtyre grave.

4. Elementet e veprës penale nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të KPRK

Në nenin 327 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të KPRK, është parashikuar se këtë formë të kësaj veprë penale të vjedhjes së rëndë e kryen “kushdo që veprën penale të vjedhjes, nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK, e kryen duke vepruar në mënyrë posaçërisht të rrezikshme apo të vrazhdë”. Trupi gjykues ka konstatuar se të akuzuarit natën kritike në mënyrë të vrazhdë kanë tentuar që të kryejnë vjedhje të rëndë ndaj të dëmtuarave N. V.dhe E. B.. Kjo për faktin se të njëjtit, natën kritike,

pas një planifikimi paraprak në mes tyre kanë tentuar që nga mbrapa dhe në mënyrë të shpejtë, duke shfrytëzuar edhe kohën e natës dhe faktin se janë femra, të dëmtuarve t'ia vjedhin çantën dhe zinxhirin e argjendtë.

5. Vlerësimi i provave

Trupi gjykues i ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe ka ardhur në përfundim se duhet ti falet besimi i plotë deklaratëve të të dëmtuarave N. V. dhe E. B., për shkak se të njejtat janë bindëse, të qarta dhe në harmoni me njëra tjetrën. Përveç këtyre, trupi gjykues ja ka falur besimin e plotë deklaratës së të dëmtuarës N. V., edhe për shkak të faktit dëshmia e saj është kuptimplote dhe e njëjta ka deklaruar në mënyrë të njëjtë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale.

Po ashtu, trupi gjykues, ja fali besimin edhe deklaratës së të akuzuarit B. N., vetëm sa i përket veprimeve të tij, i cili ka treguar se si ka tentuar për ta kryer këtë vjedhje të rëndë, mirëpo nuk ja fali besimin deklaratës së tij, sa i përket veprimeve të akuzuarit A. A., për shkak se deklarata e tij në këtë drejtim është në kundërshtim të plotë me deklaratat e të dëmtuarave, si dhe çka është e rëndësishme deklarata e të akuzuarit B. N., në këtë aspekt është në kundërshtim edhe me vetë deklaratën e të akuzuarit A. A..

Të dëmtuarat N. V. dhe E. B., i kanë përshkruar me përpikëri dhe në mënyrë të qartë të gjitha rrethanat se si është tentuar që të kryhet kjo veprë penale natën kritike dhe veprimet të cilat i kanë ndërmarrë secili prej të akuzuarve. Përmes deklaratave të dëmtuarave, janë vërtetuar të gjitha elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit A. A. dhe B. N.. Në një mënyrë, rrethanat se si ka rrjedhur ngjarja nuk kontestohen as nga të akuzuarit, ku i akuzuari B. N., e ka pranuar në tërësi kryerjen e kësaj veprë penale dhe këtë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale. Po ashtu, edhe i akuzuari A. A., e ka shpjeguar se i ka rrjedhur ngjarja natën kritike, mirëpo e ka mohuar faktin se ka tentuar që të dëmtuarës E. B., t'ia marrë zinxhirin e qafës, fakt ky që është dëshmuar pa asnjë mëdyshje nga të dëmtuarat. Andaj, në këtë aspekt, deklaratës së të akuzuarit A. A., trupi gjykues nuk ja fali besimin, ngase deklarata e tij është në kundërshtim të plotë me deklaratat e të dëmtuarave, të cilat e kanë përshkruar në mënyrë të qartë rrethanat se si ka ndodhur kjo ngjarje, në kuptim të përshkrimit edhe të veprimeve të të akuzuarit A. A..

6. Vendimi për shpalljen fajtor të të akuzuarit

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, trupi gjykues i shpalli fajtor të akuzuarit A. A. dhe B. N., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, nga neni 327

paragrafi 1 nënparagrafi 2 të KPRK, ngase veprimet e të njejtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën janë edhe penalisht përgjegjës.

7. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarve, duke u bazuar në nenet 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK, i ka marrë për bazë disa rrethana.

Në këtë aspekt, duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1 lidhur me nenin 28 paragrafi 3 të KPRK, si rrethanë mbi bazën e së cilës trupi gjykues e ka zbutur dënimin, përkatësisht ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, e ka marrë për bazë faktin se vepra penale ka mbetur në tentativë dhe nuk është shkaktuar ndonjë dëm i natyrës materiale. Përveç kësaj, si rrethana tjera lehtësuese trupi gjykues i ka marrë për bazë edhe këto rrethana : sjelljet e mira të të akuzuarve gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe pendimin e të akuzuarit B. N., për kryerjen kësaj vepre penale dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Trupi gjykues, ka vlerësuar këto rrethana, duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë rrethana që tregojnë se edhe më një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe me të drejt mund të pritet që në të ardhmen të akuzuarit nuk do të kryejnë ndonjë vepër tjetër penale.

Kurse, si rrethana rënduese, trupi gjykues për që të dy të akuzuarit e ka marrë për bazë faktin se vepra penale është kryer në bashkëpunim, ndërsa për të akuzuarin B. N., edhe faktin se i njëjti edhe më parë kanë qenë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e veprave tjera penale. Kështu, me aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.438/2006, i cili është bërë i formës së prerë më datën 13.12.2006, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje, nga neni 252 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës,³ndërsa me aktgjykimin tjetër të kësaj Gjykate, P.nr.786/2006, i cili është bërë i formës së prerë më datën 20.02.2007, i akuzuari B. N., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, nga neni 253 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPK.

8. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së trupit gjykues, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) vjet dhe dënimi me gjobë në shumë prej nga 200 € (dyqind Euro) ndaj të akuzuarve A. A. dhe B. N., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e

³ Kodi i Penal i Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPK) - Rregullorja e UNMIK-ut, nr.25/2003, e datës 06.07.2003.

përgjegjesisë së të akuzuarit. Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të të akuzuarve.

Trupi gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

9. Vendimi për kërkesën pasurore juridike

Trupi gjykues nuk ka vendosur për kërkesë pasurore juridike, ngase të dëmtuarat N. V.dhe E. B., gjatë fjalës hyrëse në shqyrtimin gjyqësor nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore juridike.

10. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarve, trupi gjykues duke u bazuar nënin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të akuzuarit A. A. dhe B. N., secilin veç e veç t'i detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej nga 30 Euro.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 25.04.2014

Sekretarja juridike,
Vahide Dërmaku

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.